

**AKTI I THEMELIMIT**  
**SHOQUERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“NEW YORK DEVELOPMENT” SH.P.K.**

**TITULLI I**

**Dizpozita te përgjithshme**

**Neni 1**

Sot, me date 05.07.2024 (dymije e njezetekater), ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar, respektivisht te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*”, Ligjt nr. 9723, date 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, krijohet shoqëria tregtare me emërtimin **“NEW YORK DEVELOPMENT”Sh.p.k**, e cila do te veproje në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nenet e ketij akti.

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 2**

Themeluesit e shoqerise **“NEW YORK DEVELOPMENT” Sh.p.k** jane:

- **Z.ALKET BANI**, atësia Servet, amësia Frosina, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në Vlore, me adresë Rruga “Fejzo Mema, Nd 27 ;H.4;AP 6;Vlore 9401 gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjostim ID nr. 035876668 dhe nr. personal I80226114N
- .

**Neni 3**

Forma ligjore e shoqerise do te jete “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar”ose SHPK. Megjithate, ajo mund te shnderohet ne një forme tjeter ne perputhje me legjislacionin tregetar shqiptar ne fuqi.



#### **Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë:

**Aktivitet ne fushen e ndertimit, germime dheu, duke perfshire te gjitha llojet e punimeve te ndertimeve, projekteve, instalime import-eksport Ndertim dhe investime ne fushen e ndertimit. Pjesemarrje dhe investime ne shoqeri me objekte aktiviteti ne fushen e ndertimit, agroturizem, investime ne energjite, imobiliare, tregti me shumice e pakice, transport, prodhim dhe perpunim, import-eksport etj.. Themelimi dhe krijimi i Shoqerive dhe Sipermarrjeve shqiptare dhe te huaja si dhe pjesmarrja ne to. Administrimi dhe drejtimi i shoqerive tregtare dhe sipermarrjeve; blerja apo disponimi me pjesmarrje ne kapital ne korporata, partneritete apo shoqeri me objekte aktiviteti te ndryshme; blerja e shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesmarrjeve te tjera ne sipermarrje dhe shoqeri, brenda kufijve te lejuar nga legjislacioni shqiptar; blerja, barresimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme apo titujve te tjere. Prodhim, import eksport dhe shitje me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit. Sherbime te ndryshme ne sferen e ndertimit. Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare qe lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore per realizimin e edo biznesi te pershtatshem ne arritjen e qellimit te shoqerise. Projekteve dhe studime urbanistike: projekteve e ndertime civile, industriale turistike, bujqesore: studime ambientale dhe vleresim te ndikimit ne Mjedis. Studime e projekteve hidrogeologjike dhe gjeologjike: projekte rrugesh, urash, porte turistike: projekte te inxhinierise elektrike, te inxhinierise hidro-mekanike: projekte konstruktive dhe supervizion punimesh, restaurime si dhe konsulenca per fushat e mesiperme. Shoqeria ka aktivitet ne fushen e vleresimit te pasurive te paluajtshm . Ka aktivitet ne veprimtarine si agjenci imobilare. Shoqeria ushton veprimtari ne administrimin e bashkepronesise ne ndertesa. Shoqeria mund te kryeje dhe te realizoje edo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, apo ka te beje me objektivat e renditura me siper. Per te arritur qellimin e mesiperme Shoqeria mund te ndermarre veprime me pasuri te luajtshme apo te paluajtshmo dhe edo aktivitet tregtar apo financiar, per dhenie me qira apo hipotekim qe mund te konsiderohen te dobishme apo te nevojshme ne menyre qe te arrihet objktivi i Shoqerise. Perveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje edo veprimtari qe do te konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundershtim me Ligjin Shqiptar..**

.

#### **Neni 5**

Shoqeria e ka seline e saj ne:

**Vlore Rruga "Fejzo Memë, Nd 27 ;H.4;AP 6;Vlore 9401.**


Ajo mund te celë dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithe territorin e Republikës se Shqiperise si dhe jashte saj.

#### **Neni 6**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

#### **Neni 7**

Shoqeria ka vulen e saj.



## TITULLI II

### Kapitali

#### Neni 8

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke  
Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e  
tyre te meposhtem:

Aksioneret e shoqerise zoterojne dhe perqindje te kapitalit si me poshte

1-Z., **ALKET BANI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 100.000  
leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

#### Neni 9

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.  
Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin  
themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte  
qe kerkohet per ndryshimin e aktit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njeften mase ndaj  
pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### Neni 10

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht.  
Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e  
ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- Shitblerjes.
- Trashegimise.
- Dhurimit.
- Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.


### Organet vendimmarrese dhe drejtuese

#### Neni 11

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me  
poshte.



## **TITULLI III**

### **Asambleja e ortakeve**

#### **Neni 12**

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarresi i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

#### **Neni 13**

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shperndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


#### **Neni 14**

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

#### **Neni 15**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.



Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 16**

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat ( $\frac{3}{4}$ ) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) Ndryshimin e statutit,
- b) Zmadhimin ose zvogelin e kapitalit te regjistruar,
- c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) Shperndarjen e fitimeve,
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) Përcaktimin e shpërblimeve
- d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **TITULLI IV**

### **Administrimi**


#### **Neni 17**

Asambleja e per gjithshme emeron një ose me shume persona si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte **5 vjet**, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

#### **Neni 18**

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij akti.

Organi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:




- a) Kryeje me mirebesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) Përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) Te punesoj, te pezulloje, te pushoj nga puna dhe te ndryshoj kushtet qe lidhen me marredhenien e punes se personelit
- g) Përfaqesojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;
- h) Te cele llogari rrjedhese bankare, te kryeje terheqje depozitim dhe te heqje parash, te jap dispozita te pageses, te verifikoje llogarite rrjedhese dhe te miratoje llogarine.
- i) Te perfaqesoje shoqerine prane organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qellim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emeruar, nese eshte e nevojshme mbrojtës te posacem.
- j) Te nenhkruaj kontrat a shitblerje te mallrave dhe sherbimeve, ne kufijte e objektit te shoqerise.

Nese asambleja e përgjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.  
Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

## Neni 19

Administrator i shoqerise **"NEW YORK DEVELOPMENT"** Sh.p.k ,emerohet:

- **Z.ALKET BANI**, atësia Servet, amësia Frosina, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në Vlore, me adresë Rruga "Fejzo Mema, Nd 27 ;H.4;AP 6;Vlore 9401 gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035876668 dhe nr. personal I80226114N



- Afati i mandatit te administratorit do te jetë 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

## Kushtet ekonomike

### Neni 20

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdom, etj.

### Neni 21

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise.

Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

### Neni 22

Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

### Neni 22


Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete akt do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

## Dispozita te vecanta

### Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

### Neni 24

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:



- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

### **Neni 25**

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

### **Neni 26**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoquerite tregtare”.

### **Baza ligjore**

### **Neni 27**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete akt dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoquerite tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

### **Neni 28**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

### **Neni 29**

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te shoqerise duke shprehur vullnetin e tij te plete e te lire.



Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Adresa e emailit te shoqerise eshte **alketbani20@gmail.com**

Numri i telefonit do te jete **+355684040195**

Lexuar, miratuar dhe nenshkruar.

**Vlore me 05.07.2024**

**ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE**  
**"NEW YORK DEVELOPMENT" Sh.p.k**

**ALKET BANI**

*ALKET BANI*

